



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 131/2015
Datë: 24.11.2015

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L – 189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 (shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe duke u mbështetur në Ligjit Nr. 02/ L-57 për Institucionet e Kulturës si dhe duke marrë për bazë Nenin 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 07/2015 për mënyrën e funksionimit, dhe kriteret e procedurat e ekspozimit në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 20.11.2015 mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Profesional i Galerisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komisioni Profesional është përgjegjës për përcaktimin e programit vjetor të ekspozitave të cilat përzgjidhen përmes konkursit publik.
2. Komisioni Profesional përbëhet nga 3 anëtarë, si në vijim:
 - 2.1. Nagip Berisha – Piktur, Profesor në Fakultetin e Arteve;
 - 2.2. Valdeta Veliu Vuçiterna – Grafist, Profesoreshë në Fakultetin e Arteve;
 - 2.3. Burim Canolli – Mr. i Skulpturës.
3. Anëtarët e Komisionit Profesional e kryejnë funksionin e vet duke u mbështetur në dispozitat e Rregullores Nr. 07/2015 për mënyrën e funksionimit dhe kriteret e procedurat e ekspozimit në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4. Anëtarët e Komisionit Profesional për punën e tyre do të kompensohen në vlerë prej 100€ (njëqind) euro për një mbledhje të mbajtur, ndërsa gjatë vitit janë të parapara të mbahen më së shumti tri mbledhje.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të emëruar;
- Departamentit Ligjor;
- Departamentit të Kulturës;
- Galerisë së Ministrisë së Kulturës;
- Arkivit të MKRS – së;

